

qershor 2023

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin maj

2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin maj

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, qershor 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkruës, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit maj 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i njëmbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Në muajin maj 2023, përmbajtjet keqinformuese në kategorinë “Clickbait” kanë mbizotëruar me 22%, por në krahasim me muajin prill 2023, ato kanë shënuar rënie të dukshme prej 20% (nga 42% në prill 2023 në 22% këtë muaj). Ajo pasohet nga dezinformata dhe lajmet e rreme me 16% secila veç e veç dhe nga publikimet e vlerësuara në kategorinë e keqinformimit “Mashtrim” me 12% që janë renditur në vendin e katërt.



22% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin “Clickbait”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. Clickbait

Artikujt në këtë kategori janë publikuar në gjuhën shqipe nga publikues të ndryshëm, por më së shumti nga mediat reale. Në këta artikuj kanë dominuar temat për kronikën e zezë, në të cilat janë trajtuar vrasje, vdekje, arrestime dhe aksidente të ndryshme. Ndërsa, në përqindje dukshëm më të vogël kishte pasur keqinformime për çështje sociale, politike dhe kuriozitetë në këtë kategori vlerësimi.

02. Dezinformatë

Përmbajtjet keqinformuese në fushën politike më së shumti kanë marrë vlerësime në kategorinë e dezinformatës dhe janë publikuar nga mediat në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Këto dezinformata janë për marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, komunitetin serb në Kosovë, shtëpinë e verdhë etj. Artikuj të tjerë në këtë kategori janë për kronikën e zezë dhe sigurinë.

03. Lajm i rremë

Në këtë kategori të keqinformimit janë publikuar artikuj me tematika të ndryshme për politikën, sigurinë, shëndetësinë, kulturën, kronikën e zezë dhe çështjet sociale. Shumica dërrmuese e tyre janë krijuar dhe shpërndarë nga publikuesit në gjuhën shqipe dhe në përqindje më të vogël nga media në gjuhë të tjera. Këto publikime keqinformuese trajtojnë tema si vrasje, pandemi, veriun e Kosovës, Eurovisionin, artikuj për Nënë Terezë dhe George Soros etj.

04. Mashtrim

Përmbajtjet keqinformuese në këtë kategori për muajin maj 2023 janë publikuar dhe shpërndarë nga publikues në gjuhën shqipe kryesisht për çështje sociale dhe shpallje të ndryshme, si dhënie të kredive, shitje të banesave dhe lidhje dashurie.

05. Gabim

Edhe në këtë kategori vlerësimi janë shpërndarë artikuj keqinformuese nga publikuesit në gjuhën shqipe. Artikujt që kanë marrë vlerësime “Gabim” janë në fushën sociale, të sportit dhe sigurisë.

06. Përmbajtje e paverifikuar


Edhe publikimet keqinformuese me përmbajtje të paverifikuar janë krijuar e shpërndarë nga publikues në gjuhën shqipe në tema të ndryshme, si për politikë, siguri, kulturë, kronikë të zezë dhe çështje sociale.

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë “Manipulim i fakteve”, “Teori konspirative”, “Spin” dhe nga kombinimi i kategorive “Lajm i rremë / Dezinformatë” dhe “Përmbajtje e paverifikuar / Teori konspirative”.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

KATEGORITË KRYESORE


Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Ngjashëm si në muajin paraprak (prill 2023), edhe këtë muaj veriu i Kosovës është tema kryesore e trajtuar nga media dhe publikues të ndryshëm në kontekst të ngjarjeve politike dhe të sigurisë në veri. Kjo ndërlidhet me zhvillimet në veri si pasojë e mbajtjes së zgjedhjeve lokale në katër komunat veriore të Kosovës në prill të vitit 2023 dhe rrjedhimisht gjatë javëve pasuese në muajin maj 2023 kishte dinamikë të theksuar të zhvillimeve në veriun e vendit, përfshirë betimin e kryetarëve të rinj në këto komuna. Siç dihet, zgjedhjet në këto komuna u bojkotuan nga subjektet politike serbe dhe qytetarët e komunitetit serb për shkak të presioneve nga Lista serbe dhe Serbia, ndërsa kryetarët e rinj shqiptarë janë zgjedhur nga subjektet politike shqiptare të Kosovës që operojnë në komunat veriore të vendit.

Përmbajtjet keqinformuese më së shumti janë krijuar dhe shpërndarë nga publikuesit në gjuhën shqipe dhe pjesa tjetër nga mediat në gjuhën serbe, si dhe shumica dërrmuese e këtyre publikimeve janë në fushën e sigurisë dhe më pak në atë të politikës. Publikuesit në gjuhën shqipe kanë shpërndarë artikuj keqinformues për të vlarë dhe të plagosur në Mitrovicë, pretendime të pabaza se kryeministri shqiptar, Rama, ka krahasuar ushtrinë serbe me atë të Kosovës, kërkesat e zyrtarëve të shtetit amerikan për shmangien e veprimeve provokuese në veri etj. Ndërkaq, përmbajtjet keqinformuese të mediave në gjuhën serbe kanë ngritur pretendime të ndryshme të pabaza se kryeministri Kurti po përgatit incidente në veri, citohen zyrtarë serbë se Kosova po planifikon t'i marrë me forcë katër komunat veriore etj.

Gjatë këtij muaji janë trajtuar edhe tema tjera, si vrasje, ushtrimi "Defender Europe 2023", lidhje dashurie, marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe SHBA-së etj.



38% e temave kryesore janë për veriun e Kosovës, vrasje, ushtrimi "Defender Europe 2023", lidhje dashurie, marrëdhëniet mes Kosovës dhe SHBA-së etj.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Ngjarjet në veriun e Kosovës dhe tema të tjera, si vrasje, ushtrimi “Defender Europe 2023” dhe lidhje dashurie kanë mbizotëruar gjatë këtij muaji monitorues. Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga mediat e ndryshme, sipas matjeve të “hibrid.info” përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Veriu

Përmbajtjet keqinformuese për veriun janë vlerësuar në kategori të ndryshme vlerësimi, si teori konspirative, përmbajtje e paverifikuar, manipulim i fakteve, lajm i rremë, clickbait dhe gabim. Të dhënat e monitorimit tregojnë se mediat në gjuhën serbe kryesisht kanë publikuar teori konspirative dhe manipulim të fakteve sa i përket veriut të Kosovës, ndërsa artikujt keqinformuese të publikuesve në gjuhën shqipe për veriun kanë marrë vlerësime clickbait, gabim, lajm i rremë dhe përmbajtje të paverifikuar.

02. Vrasje

Artikujt me përmbajtje keqinformuese që kanë trajtuar temën e vrasjeve janë krijuar dhe shpërndarë nga media dhe publikues në gjuhën shqipe. Artikuj të tillë kanë marrë vlerësime clickbait, dezinformatë dhe lajme të rreme.

03. Ushtrimi “Defender Europe 2023”

Publikimet keqinformuese në lidhje me këtë ushtrim ushtarak shumëkombësh të vendeve partnere të NATO-s dhe SHBA-së janë krijuar e shpërndarë nga mediat në gjuhën serbe. Ato janë vlerësuar si dezinformata, manipulim të fakteve dhe spin. Këta artikuj përmbajnë pretendime të pavërteta lidhur me planet për mbajtjen e ushtrimit “Defender Europe 23” në Kosovë, duke cituar zyrtarë rus dhe media në gjuhën ruse.


04. Lidhje dashurie

Raportimet keqinformuese për lidhje dashurie, të cilat janë kategorizuar si mashtrim, janë publikuar e shpërndarë nga portale të dyshimta dhe publikues në mediat sociale që operojnë në gjuhën shqipe.

Llojet e fushave

Tema e veriut të Kosovës dhe tema të tjera politike e të sigurisë (ushtrimi “Defender Europe 2023”, raportet Kosovë-SHBA etj.) kanë ndikuar që pjesa më e madhe e artikujve keqinformuese të këtij muaji të jenë në fushën politike me 31% dhe të sigurisë 17%, përdherisa të dyja së bashku përbëjnë 48% të të gjitha publikimeve për muajin maj 2023. Kjo është hera e parë pas disa muajsh që ka më pak përmbajtje keqinformuese në fushën sociale dhe të kronikës së zezë, të cilat ngjashëm si siguria, ndajnë 17% të publikimeve secila prej tyre gjatë këtij muaji monitorues.

FUSHAT KRYESORE
Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Shumica e artikujve keqinformues në fushën politike janë publikuar nga publikues në gjuhën shqipe dhe pjesa tjetër nga mediat në gjuhën serbe. Edhe publikuesit në gjuhën shqipe, por edhe mediat në gjuhën serbe, në fushën politike, kanë trajtuar më së shumti dezinformata për zhvillimet rreth Kosovës. Në kuadër të fushës politike janë publikuar përmbajtje të ndryshme keqinformuese, si veriu i Kosovës, komunat me shumicë serbe, raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, protestat opozitare në Serbi etj.

Shumica e artikujve keqinformues në fushën politike janë publikuar nga publikues në gjuhën shqipe dhe pjesa tjetër nga mediat në gjuhën serbe. Edhe publikuesit në gjuhën shqipe, por edhe mediat në gjuhën serbe, në fushën politike, kanë trajtuar më së shumti dezinformata për zhvillimet rreth Kosovës. Në kuadër të fushës politike janë publikuar përmbajtje të ndryshme keqinformuese, si veriu i Kosovës, komunat me shumicë serbe, raportet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, protestat opozitare në Serbi etj.

Publikimet keqinformuese në fushën sociale dhe të kronikës së zezë janë krijuar dhe shpërndarë nga publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe. Artikujt me tematikë të kronikës së zezë kryesisht janë vlerësuar si clickbait, kurse në fushën sociale, përveç clickbait, edhe në kategoritë e mashtrimit dhe gabimit.




87% e përmbajtjeve keqinformuese janë për politikën, sigurinë, çështjet sociale, kronikën e zezë dhe shpalljet.

4

Llojet e publikuesve

Ngjashëm si në muajin prill 2023, edhe gjatë këtij muaji (maj 2023), mediat reale dhe publikues të ndryshëm në mediat sociale kanë krijuar e shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese për Kosovën. Sipas të dhënave të monitorimit, 50% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar dhe shpërndarë nga mediat reale dhe 41% nga publikuesit në mediat sociale. Ndërsa, 9% e artikujve keqinformues janë publikuar nga portalet e dyshimta.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE



91% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga mediat reale (50%) dhe publikuesit në mediat sociale (41%).

5

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në raport me Kosovën.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Gjatë këtij muaji, publikues të ndryshëm në gjuhën shqipe kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 76%, kurse 21% e përmbajtjeve keqinformuese janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe. Në krahasim me muajin prill 2023, gjatë këtij muaji shihet se ka rënie të publikimeve në gjuhën shqipe (rënie prej 12%) dhe rritje të dukshme të publikimeve në gjuhën serbe (rritje prej 9%). Gjithashtu, në muajin 2023, rreth 3% e publikimeve keqinformuese janë shpërndarë nga media në gjuhë të tjera.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet e mediave në gjuhën shqipe

Gjysma e publikimeve në gjuhën shqipe janë krijuar dhe shpërndarë nga publikues në mediat sociale dhe pjesa tjetër nga mediat reale, ndërsa në numër më të vogël nga portalet e dyshimta. Artikujt keqinformues në gjuhën shqipe janë vlerësuar më së shumti si clickbait dhe pjesa tjetër si mashtrim, lajm i rremë, dezinformatë, përmbajtje e paverifikuar dhe gabim. Publikuesit në gjuhën shqipe kanë shpërndarë më së shumti keqinformime në fushën politike, e cila pasohet nga përmbajtjet për çështje sociale dhe kronikës së zezë, si dhe dukshëm më pak në fushën e sigurisë.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe

Të gjitha publikimet keqinformuese të mediave në gjuhën serbe, gjatë këtij muaji, janë publikuar në fushën politike dhe të sigurisë lidhur me ngjarje rreth Kosovës. Publikimet e këtyre mediave kanë marrë më së shumti vlerësime të dezinformative, teorive konspirative dhe manipulimit të fakteve, në kuadër të pretendimeve të mediave në gjuhën serbe, të pabazuara në fakte, për veriun e Kosovës, ushtrimin “Defender Europe 2023”, komunitetin serb në Kosovë etj.

03. Publikimet e mediave në gjuhë të tjera


Gjatë këtij muaji, dy publikime keqinformuese janë publikuar nga publikues në gjuhë të tjera, të vlerësuara si lajme të rreme, por që nuk kanë ndërlidhje me zhvillimet rreth Kosovës. Këto publikime përmbajnë keqinformime për miliarderin George Soros dhe pretendimin e pavërtetë për shpërthim në ndërtesën e Pentagonit në SHBA.

Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Gjatë këtij muaji vërehet rënie e dukshme e publikimeve keqinformuese në Facebook dhe rritje e tyre në TikTok dhe Twitter në krahasim me muajin paraprak (prill 2023). Për më tepër, këtë muaj, 46% e publikimeve keqinformuese u shpërndanë në Facebook në krahasim me 62% gjatë muajit të kaluar (rënie prej 16%). Edhe në TikTok, gjatë majit 2023, u publikuan 46% të përmbajtjeve keqinformuese në krahasim me 38% gjatë prillit 2023 (ritje prej 8%). Ndërkaq, rreth 8% e publikimeve keqinformuese këtë muaj janë publikuar në Twitter, por që nuk ndërlidhen me ngjarje rreth Kosovës.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje analizon, përmes të dhënave monitoruese, ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, faqeve zyrtare, llogarive dhe profileve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Gjatë këtij muaji, publikuesit në Facebook (faqet me 42% dhe faqet zyrtare me 4%) dhe TikTok (llogaritë me 46%) kanë publikuar në përqindje të njëjtë artikuj keqinformues për Kosovën. Ndërsa, rreth 8% e publikimeve tjera janë shpërndarë nga llogari të ndryshme në Twitter. Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese në mediat sociale për këtë muaj janë publikuar në gjuhën shqipe.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese.

01. Facebook

Faqet - Publikimet keqinformuese të faqeve në Facebook janë në fusha të ndryshme, si për çështje sociale, politike, shpallje, kronikë të zezë, kulturë dhe siguri. Ato kanë marrë më së shumti vlerësime clickbait dhe mashtrime.

Faqet zyrtare - Kurse, në faqet zyrtare të kësaj media sociale është publikuar vetëm një artikull keqinformues këtë muaj lidhur me çështje politike, e cila është vlerësuar si dezinformatë. Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të publikuesve në Facebook janë në gjuhën shqipe.

02. TikTok


Llogaritë në TikTok kanë publikuar më së shumti artikuj keqinformues për çështje politike, e cila pasohet nga përmbajtje në fusha tjera (sociale, shëndetësi etj.). Publikuesit në TikTok kanë shpërndarë në përqindjen më të madhe lajme të rreme dhe shumë më pak mashtrime, dezinformata dhe teori konspirative. Edhe në këtë media sociale të gjitha publikimet janë në gjuhën shqipe për këtë muaj.

03. Twitter

Publikimet e profileve në Twitter janë publikuar në gjuhën angleze lidhur me ngjarje jashtë Kosovës. Këto përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar si lajme të rreme në fushën politike dhe të sigurisë. Po ashtu, në bazë të monitorimit gjatë këtij muaji, në Twitter, nuk kishte publikime keqinformuese në gjuhën shqipe.

Figurat dhe institucionet më të përfolura


Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.



Institucioni ose organizata ndërkombëtare më e përfolur këtë muaj është NATO në kuadër të ushtrimit “Defender Europe 2023”. NATO-ja është përfolur nga mediat në gjuhën serbe për këtë ushtrim ushtarak në kontekst të planeve për organizimin e këtij ushtrimi në Kosovë, si një vendet nikoqire në Ballkanin Perëndimor, pos Shqipërisë. “Defender Europe” udhëhiqet nga Komanda Evropiane e SHBA-ve, si formë bashkëpunimi mes aleatëve dhe partnerëve të SHBA-së dhe NATO-s. Mediat në gjuhën serbe, duke cituar edhe zyrtarë rus, kanë ngritur pretendime të paverifikuara dhe të pabazuara në fakte se ky ushtrim ushtarak përbën provokim kundër serbëve në Kosovë.

Institucione tjera të përfolura janë Policia e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Ngjashëm si në muajt paraprakë, monitorimi gjatë muajit maj 2023 ka treguar se kryeministri Albin Kurti është personaliteti më i përfolur dhe atë më shumë nga mediat në gjuhën serbe dhe më pak nga publikimet keqinformuese në gjuhën shqipe. Mediat në gjuhën serbe kanë pretenduar pa fakte se Kurti po përgatit incidente në veri të Kosovës, se do t'i dëbojë serbët nga Kosova etj. Ndërkaq, publikuesit në gjuhën shqipe, në mediat sociale, kanë publikuar dezinformata dhe lajme të rreme ndaj Kurtit se do të takohet me zëvendës-presidenten e SHBA-së, Kamala Harris dhe duke publikuar një fotografi të montuar se ai ishte takuar me ish-politikanin serb, Vojislav Koshtunica.

Personalitete të tjera të përfolura janë kryeministri shqiptar, Edi Rama, zyrtari i Departamentit të Shtetit Amerikan, Derek Chollet, zyrtarja e Ministrisë së Jashtme ruse, Maria Zakharova etj.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 maj 2023.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit maj 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit maj 2023 kanë mbizotëruar publikimet keqinformuese në kategorinë clickbait me 22% në vendin e parë, e cilat pasohet nga dezinformatat dhe lajmet e rreme me 16% secila prej tyre dhe mashtrim me 12%. Përmbajtjet keqinformuese në kategorinë “Clickbait” janë publikuar kryesisht për kronikën e zezë, në të cilat përfshihen vrasje, vdekje, arrestime dhe aksidente. Vlerësime “Dezinformatë” kanë marrë artikujt në fushën politike për raportet Kosovë–Serbi, komunitetin serb në Kosovë etj., por edhe në fusha tjera, si kronika e zezë dhe siguria. Ndërkaq, në kategorinë “Lajm i rremë” janë trajtuar çështje të ndryshme politike, të sigurisë, shëndetësisë, sigurisë, kulturës, kronikës së zezë dhe tema sociale. Në kategorinë “Mashtrim” janë publikuar kryesisht keqinformime me tematikë sociale dhe të shpalljeve.

Gjatë muajit maj 2023, media dhe publikues të ndryshëm kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese për veriun e Kosovës, në gjuhën shqipe dhe serbe, si pasojë e zhvillimeve në veri pas zgjedhjeve në katër komunat veriore të Kosovës në prill të vitit 2023. Tema të tjera të trajtuara janë vrasje, ushtrimi ushtarak “Defender Europe 2023”, lidhje dashurie, raportet mes Kosovës dhe SHBA-së etj. Sa i përket fushave tematike të keqinformimit për këtë muaj, çështjet politike kanë mbizotëruar më së shumti me 31% dhe siguria me 17%, të cilat pasohen nga çështjet sociale dhe kronika e zezë më 17% po ashtu secila prej tyre. Në krahasim me muajin paraprak, këtë muaj vërehet se kishte dukshëm më shumë përmbajtje keqinformuese për politikën dhe sigurinë, si dhe më pak për kronikën e zezë dhe çështjet sociale.

Mediat reale kanë shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese me 50%, të cilat pasohen nga publikues të ndryshëm në mediat sociale me 41% dhe portalet e dyshimta me 9%. Publikuesit në gjuhën shqipe kanë shpërndarë më së shumti keqinformime në fushën politike, sociale dhe kronikës së zezë, si dhe dukshëm më pak në fushën e sigurisë. Ndërsa, mediat në gjuhën serbe kanë krijuar e shpërndarë artikuj keqinformues lidhur me Kosovën në fushën politike dhe të sigurisë, ngjashëm si në periudhat e mëhershme njëmuje. Sa i përket mediave sociale, publikuesit në Facebook dhe TikTok kanë publikuar në përqindje të njëjtë përmbajtje keqinformuese për dhe rreth Kosovës me 46% secila prej tyre veç e veç, si dhe 8% në Twitter. Pothuajse të gjithë artikujt keqinformues në mediat sociale janë publikuar në gjuhën shqipe dhe temat mbizotëruese janë politika, çështjet sociale dhe siguria.

Institucioni më i përfolur në raportimet keqinformuese të mediave gjatë këtij muaji është NATO. Mediat në gjuhën serbe kanë përfolur këtë organizatë ndërkombëtare në lidhje me ushtrimin ushtarak “Defender Europe 2023” i planifikuar të mbahet edhe në Kosovë, në kuadër të ushtrimeve në Ballkanin Perëndimor. Mediat në gjuhën serbe kanë ngritur pretendime të pavërteta se ky ushtrim ushtarak përbën provokim kundër serbëve në Kosovë. Institucione tjera të përfolura janë Policia e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe. Sa i përket personaliteteve, kryeministri Albin Kurti vazhdon të jetë më i përfoluri nga mediat në përmbajtjet e tyre keqinformuese. Këtë muaj, Kurti më shumë është përfolur nga mediat në gjuhën serbe, në kontekst të zhvillimeve politike e të sigurisë në veri, duke pretenduar pa fakte se ai po përgatit sulme kundër serbëve dhe se do t'i dëbojë serbët nga Kosova. Ndërkaq, publikuesit në gjuhën shqipe kanë shpërndarë dezinformata dhe lajme të rreme ndaj Kurtit gjatë muajit maj 2023.

HIBRIDO.INFO